



BASHKIA FUSHË-ARRËZ

PLANI I INTEGRITETIT

2025-2027

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 27.01.2025



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Strengthening and Advancing Local Governance Reform

Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz:

Grupi i Punës, IDM:

Dr. Nysjola Dhoga, Eksperte për Etikën dhe Integritetin
Megi Reçi, Eksperte për Etikën dhe Integritetin
Diori Angjeli

Ky Plan Integriteti është hartuar në kuadër të komponentit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" të projektit STAR3 "Mbështetja dhe avancimi i reformave të qeverisjes vendore". Projekti STAR3 zbatohet nga UNDP në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe pushtetin vendor dhe financohet nga Bashkimi Evropian, Qeveria e Suedisë, Qeveria e Zvicrës, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, UNDP në Shqipëri dhe Qeveria e Shqipërisë. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e UNDP-së në Shqipëri, apo të partnerëve të saj zbatues dhe financues.



Funded by
the European Union

Shqipëria dhe bashkëpunimi
Cooperation for
Sustainable Growth
Cooperation with
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



SHKURTESA DHE AKRONIME

GPI	Grupit të Punës për Integritetin
PI	Plani i Integritetit
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
AB	Auditi i Brendshëm
BNJ	Burime Njerëzore
PSV	Procedura Standarde Veprimi

Tabela e përmbajtjes

1. Rëndësia e Planit të Integritetit	5
1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit	5
1.2 Qasja metodologjike	6
2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit	7
3. Plani i veprimit	8

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, përballen me risqe korrupsioni që mund të kenë pasoja negative në përmbushjen e objektivave të synuara. Risku i integritetit është një problem ekzistues për të gjitha nivelet e qeverisjes. Gjithsesi në vetëqeverisjen vendore ai bëhet edhe më i ndjeshëm duke qenë se bashkitë qeverisin më pranë qytetarëve e si rrjedhojë kontaktet ndërmjet zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe publikut janë më të shpeshta, duke rritur kështu dhe mundësitë për shfaqjen e risqeve të tilla si raste të shfaqjes së konfliktit të interesit, nxjerrje e një informacioni konfidencial apo privat, diskriminim, etj. Nga ana tjetër bashkitë e vogla përballen me sfida të shtuara për sigurimin e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknike për përmbushjen e funksioneve të tyre me një standard të lartë për qytetarët. Si rrjedhojë, Bashkia Fushë-Arrëz ka ndërmarrë nismën për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027 me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm.

1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi nëpërmjet vlerësimit të fushave të veprimtarisë administrative dhe fushave të funksioneve kryesore që Bashkia gëzon sipas ligjit. Më konkretisht, gjatë procesit u vlerësua: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për të drejtën e informimit dhe njoftimit e konsultimit publik; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe e mekanizmave kundër korrupsionit që përfshin edhe zbatimin e legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit dhe vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve e të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike. Vlerësimi u zhvillua nga një Grup Punë i ngritur nga Kryetari i Bashkisë ku bënë pjesë përfaqësues të administratës së bashkisë nën drejtimin e ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë periudhës mars-qershor 2024.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Fushë-Arrëz kaloi në fazat e mëposhtme:

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Plani i Integritetit është në thelb një instrument vetëvlerësimi nga stafi i bashkisë dhe një strategji masash të cilat konsiderohen të realizueshme, ndaj hapi i parë i procesit të hartimit të planit të integritetit konsiston në ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga administrata dhe nga nëpunës të fushave kryesore të funksioneve të bashkisë. Grupi i punës u prezantua me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me hapat e punës si dhe u trajnua mbi çështjet e integritetit dhe etikës në administratën publike. Së fundi, në këtë fazë u bë komunikimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të Integritetit me administratën e bashkisë, nga ana e Grupit të Punës.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan 7 grupe të fokusuara me punonjësit e bashkisë sipas fushave të kompetencave të përgjithshme dhe funksionale. Në këtë fazë, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit.

Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit

Grupi i Punës në bashkëpunim me ekspertët e IDM bëri vlerësimin e risqeve të integritetit. Risqet e identifikuara u vlerësuan në lidhje me:

- mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun; si edhe
 - pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në bashki nëse do të ndodhte.
- Mundësia e ndodhjes së riskut dhe ndikimi i tij, u nda në tre kategori vlerësimi: i lartë/i moderuar/ i ulët. Së fundi, risqet u renditën sipas prioritetit.

Faza 4: Plan i masave për menaxhimin e integritetit

Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit shërben për vetëdijësimin e stafit për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të punës së tyre. Nga analiza e të dhënave rezultoi se Bashkia Fushë-Arrëz ka mangësi në plotësimin e kuadrit rregullator për etikën dhe integritetin në kapacitete njerëzore, financiare dhe teknike për zbatimin e objektivave të saj strategjik, në transparencë dhe llogaridhënie të pjesshme ndaj qytetarëve, por edhe faktorë të tjerë risqesh që lidhen me ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e funksioneve të veta ndaj qytetarëve. Në përfundim të fazës së renditjes së risqeve sipas prioriteteve Grupi i Punës diskutoi mbi hartimin e një plani me masa konkrete për adresimin e risqeve të evidentuara. Plan i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë Fushë-Arrëz, afatet kohore dhe personat përgjegjës. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plan i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

1.2 Qasja Metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit realizohet në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe përdor një qasje metodologjike cilësore dhe sasiore. Në lidhje me metodën cilësore ajo ndahet në dy komponentë:

1. Analiza e kuadrit të brendshëm rregullator të Bashkisë në të cilën shqyrtohet nëse bashkia ka zbërthyer kërkesat e legjislacionit në fuqi përshëmbull nëse ka një rregullore të brendshme që përmban të gjitha përshkrimet e punës dhe linjat hierarkike të

llogaridhënie, rregullora për etikën, rregullore për parandalimin e Konfliktit të Interesit apo për mbrojtjen e sinjalizuesve sipas modelit tip të ILDKPKI, si dhe urdhra apo procedura të tjera. Në vijim, nëse bashkia është e pajisur me aktet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, Grupi i Punë zhvillon një analizë cilësore për përputhshmërinë dhe plotësinë e tyre.

2. Stafi i bashkisë merr pjesë në grupe të fokusuara ku diskutohet lirisht për problematikat që mund të përbëjnë risk integriteti gjatë praktikës së punës së tyre, si përsëmbull nevoja për trajnime apo kualifikime shtesë, për mjete teknologjike apo mangësi në burimet financiare.

Metoda e dytë është ajo sasiore ku të gjithë punonjësve të administratës së bashkisë ju shpërnda një anketë anonime e cila përfshinte pyetje mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Anketimi përfshiu një kampion prej 44 punonjësish me një nivel besueshmërie 95% dhe marzh gabimi 5%. Të anketuarit femra përbënin 54.5% ndërsa meshkuj 45.5%. Punonjësit e moshës 26-35 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 31.8% të të anketuarve, të ndjekur nga grupmosha deri në 25 vjeç dhe 36-45 vjeç secila me 18.2%. Ndërkohë mosha 46-55 dhe mbi 56 vjeç përfaqësohej me nga 15.9% secila. Gjithsesi, pavarësisht një ndarje të harmonizuar sipas moshës, pjesa më e madhe e punonjësve nuk kanë një eksperiencë të gjatë pune në bashki pasi 52.3% kanë më pak se 5 vite vjetërsi pune në bashki dhe 27.3% kanë 5-10 vjet eksperience pune ndërkohë me mbi 10 vjet eksperiencë në bashki janë rreth 20% e kampionit.

2. Objektivat e identifikuar dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit

2.1 Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe transparencë

Kuadri i brendshëm rregullator është thelbësor për një qeverisje me integritet, duke qënë se hedh bazat e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së bashkisë në mënyrë etike. Nga analiza e dokumentacionit ekzistues Grupi i Punës konstatoi se pavarësisht përpjekjes për të patur një përputhshmëri me kuadrin ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë, në Bashkinë Fushë-Arrëz lindte nevoja për përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator si hartimi i rregullores së re për parandalimin e konfliktit të interesit duke zëvendësuar në kontekstin e bashkisë modelin e ILDKPKI dhe ngritjen e autoritetit përgjegjës. Një nga elementet thelbësorë të mirëqeverisjes demokratike është transparencë dhe vendimmarrja pluraliste. Vetëm në këtë mënyrë publiku dhe grupet e tjera të interesit informohen se si bashkia është duke administruar interesin e përgjithshëm të komunitetit, si dhe mund të marrin pjesë nëpërmjet konsultimit në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje. Gjithsesi nga vlerësimi i risqeve u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz kishte mangësi në ndarjen proaktive të informacionit me publikun pasi zërat e programit të transparencës nuk ishin të populluara. Këto risqe u bënë pjesë e planit të veprimit dhe angazhimit të bashkisë për t'i minimizuar në një periudhë afatmesme.

2.2 Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion do të sigurojë kapacitete dhe aftësi të nevojshme për të zbatuar dhe konsoliduar mekanizmat garantues të integritetit në institucion me qëllim rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve në përputhje me performancën në punë. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut u konstatua se Bashkia Fushë-Arrëz përballej me numër të kufizuar punonjësish dhe me paga të ulëta të cilat demotivonin stafin ekzistues. Nga ana tjetër, nevojitej një planifikim më i mirë i programeve të kualifikimit të stafit nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga institucionet e përgjithshme si ato në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit apo mbi risitë në fushën e prokurimeve publike, por edhe i planeve të trajnimeve për transferimin e brendshëm të njohurive mbi kuadrin rregullator të bashkisë.

2.3 Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë

Në lidhje me fushat e veçanta të bashkisë u konstatuan një sërë risqesh në fushën e menaxhimit financiar që lidheshin me kapacitetet e bashkisë për të realizuar shpenzimet apo të ardhurat e tyre dhe që kërkonin një mirëplanifikim dhe rakordim në nivel programesh, por edhe pajisjen me programet digjitale të nevojshme financiare. Edhe pse Bashkia Fushë-Arrëz është një nga rrethet më të pyllëzuara në Shqipëri asaj i mungojnë planet e riabilitimit të pyjeve dhe ujrave për zhvillim të qëndrueshëm në Planin e Përgjithshëm Vendorë apo ishte në faza fillestare edhe procesi për të patur një Plan të Detajuar Vendor. Nga ana tjetër bashkia përballlet me kapacitete njerëzore të pamjaftueshme dhe mungesë kualifikimesh sipas kuadrit rregullator të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, si dhe me kapacitetet financiare dhe teknike të pamjaftueshme për realizimin e detyrave funksionale në terren për pronat dhe planifikimin e territorit. Sigurimi i fondeve të mjaftueshme edhe financiare për minimizimin e këtyre risqeve është një sfidë që shkon përtej kapacitetit të bashkisë, por kërkon një rol koordinues në nivel politik edhe nga AMVV në mënyrë që qytetarët të kenë një akses në shërbime me një standard të përafërt në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë Fushë-Arrëz. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikente, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetet e risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Bashkia i Raporton çdo vit AMVV mbi procesin e vet të zbatimit të Planit të Integritetit dhe procesin e monitorimit.

<i>Objekti 1: Forcimi i kushtit të brendshëm rregullator dhe transparencë</i>					
Nr.	Risiku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të risikut	Prioriteti i lartë; Prioriteti i moderat; Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Bashkia nuk ka cakuar autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në bashki.	<i>Operationet (Processi)</i>	I lartë	1. Miratimi i urdhrave për caktimin e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në bashki. 2. Informimi i stafit të bashkisë në lidhje me autoritetin përgjegjës dhe detyrat e tij.	Kryetari Gjastërmujori i parë 2025
2	Mungon rregulloja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.	<i>Operationet (Processi)</i>	Mesatar	1. Miratimi dhe miratimi i rregullorës së brendshme të bashkisë për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. 2. Informimi i stafit të bashkisë për rregulloren detyrues ligjore në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit.	Autoriteti Përgjegjës Gjastërmujori i dytë 2025
3	Bashkia nuk ka miratuar dhe publikuar programin e transparencës.	<i>Operationet (Processi)</i>	I ulët	Miratimi dhe publikimi i Programit të Transparencës së bashkisë në përputhje me udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe legjislacionin përkatës. Përfundimi i vazhdueshëm i Programit të Transparencës me informacionin e nevojshëm.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit/Grup Punë Gjastërmujori i parë 2025

Objektivi 2: Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e rësjeve të integritetit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti i lartë; Prioriteti i moderuar; Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerrin për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktivitetëve
4	Mungesa e rimbursimit të kostove të trajnimeve dhe certifikimeve profesionale nga institucionet, krijon barrë financiare për punonjësit.	Burimet Njerëzore	Mesatar	Alokimi i një zëri të posaçëm buxhetor për mbulimin e kostove të trajnimeve dhe certifikimeve profesionale për punonjësit e bashkisë.	Burimet Njerëzore/Financa Gjastërmujori i dytë 2025
5	Kapacitete të kufizuara të stafit në përdorimin e sistemit elektronik për pasqyrimin e të dhënave të PBA-së dhe buxhetit.	Burimet Njerëzore	Mesatar	Trajnimi i vazhdueshëm i stafit për përdorimin efektiv të sistemit elektronik për pasqyrimin e të dhënave të PBA-së dhe buxhetit. Përfshirja në planin vijtor të trajnimeve për stafin e bashkisë.	Burimet Njerëzore/Financa Gjastërmujori i parë 2025
6	Njohje e kufizuar e rregullave të reja të kontabilitetit nga punonjësit e bashkisë.	Burimet Njerëzore	Mesatar	Organizimi i trajnimeve për stafin mbi rregullat e reja të kontabilitetit dhe përditësimin mbi legjislacionin përkatës. Përfshirja në planin vijtor të trajnimeve për stafin e bashkisë.	Burimet Njerëzore/Financa Gjastërmujori i parë 2025
7	Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë të përherëshëm duke krijuar ngarkesë në punë dhe nivel të lartë ekspozimi ndaj situatave të konfliktit të interesit.	Burimet Njerëzore	Uletë	Sigurimi i rotacionit të vazhdueshëm të anëtarëve të KVO-së për të shmangur mbingarkesën në punë dhe ekspozimin e lartë ndaj situatave të konfliktit të interesit.	Kryetari Gjastërmujori i parë 2025
8	Stafi i bashkisë nuk është i informuar mbi legjislacionin përkatës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit.	Burimet Njerëzore	Uletë	Organizimi i trajnimeve për stafin mbi legjislacionin për sinjalizimin. Përfshirja në planin vijtor të trajnimeve për stafin e bashkisë.	Njësia Përgjegjëse/Burimet Njerëzore bashkëpunim me ILDRPKI Gjastërmujori i parë 2025
9	Kapacitete të kufizuara financiare, burimesh njerëzore dhe teknike për realizimin e funksioneve të shërbimeve publike sidomos në nivel Njësish Administrative.	Operacionet (Procesi)	Uletë	Analizë e kapaciteteve ekzistuese dhe hartimi sipas prioritetëve i planifikimit për shërbimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike.	Kryetari/Grup Punë Gjastërmujori i parë 2026

ne process

10.	Bashkia nuk ka një njësi të dedikuar për menaxhimin e aseteve vendore.	<i>Burimet Njerëzore</i>	Mesazh	Parashikimi i një njësie të dedikuar për menaxhimin e aseteve në strukturën e brendshme të bashkisë. Mënyra e masive për pajisjen e njësisë me burime njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara.	Kryetari/Burimet Njerëzore Gjastëmuajt i parë 2025
-----	--	--------------------------	--------	---	---

<i>Objektivi 3: Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të vecanta të përgjegjësisë së bashkisë</i>					
Fusha e Menaxhimit Financiar					
Nr.	Risiko dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioriteti i lartë, Prioriteti i modëruar, Prioriteti i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afat i fundit për zbatimin e aktivitetëve
11.	Plani i grumbullimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet pjesërisht, për shkak të vështirësive në identifikimin e taksupaguesve dhe ndërtimeve. Mungon një databazë të dhënash për subjektet tatimpaguese.	Operacionel(Procesi)	Mesazh	Ndjekja e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkitimin e detyrimeve të prapambetura. Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi me OSHEE për të lehtësuar procesin e vijes së detyrimeve ndaj bashkisë. Hartimi i një databazë të dhënash të përditësuar për subjektet tatimpaguese.	Grup Pune Gjastëmuajt i dytë 2026 e në vijimësi
12.	Procesi i kontabilizimit është manual dhe nuk është i digitalizuar.	Operacionel(Procesi)	Mesazh	Digitalizimi i procesit të kontabilizimit në bashki. Sigurimi i programeve përkatëse të kontabilitetit për këtë proces.	Financa Gjastëmuajt i dytë 2025 e në vijimësi

13.	Derivime të papagjura të prapambetura ndaj bashkisë nga të tjerët.	Operacionet(Procesi)	Mesazhar	Ndjekja e të gjithë procedurave ligjore për të siguruar arkëtimin e derivateve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.	Financa Gjastënujori i dytë 2025 e në vijimësi
13.	Mos realizimi i plotë të buxhetit ka ndikuar në mos realizimin e shpenzimeve operative dhe investimeve.	Operacionet(Procesi)	Mesazhar	Rishikimi i planifikimeve buxhetore përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi duke përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.	GMS Gjastënujori i parë 2025 e në vijimësi
14.	Mungesa e burimeve financiare dhe njëzore parrandësojnë zbatimin e objektivave të PPV në praktikë	Operacionet(Procesi)	Planifikim	Analizë e realizimit të objektivave të PPV periodikisht në kuadër të rishikimit të masave për plotësimin me burime njëzore dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për zhvillimin e territorit në Bashki.	Grup Pune Gjastënujori i dytë 2026
Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit					
15.	Mungojnë planet e rimbullimit të pyjeve dhe ulrave për zhvillim të qëndrueshëm në PPV.	Operacionet(Procesi)	Monitorim	Monitorim i PPV dhe vlerësimi i mundësisë nga Bashkia Fushë-Arrëz për të hartuar plane për rimbullimin e pyjeve dhe Ulrave	Grup Pune Gjastënujori i dytë 2026
16.	Mungesa e Planit të Detajuar vendor sipas prioritetëve në përgjithësi me Planin e Përgjithshëm vendor të miratuar për bashkinë.	Operacionet(Procesi)	Planifikim	1. Hartimi i planit të detajuar vendor sipas parashikimeve të bëra në Planin e Përgjithshëm vendor. 2. Të kryhet konsultimi publik me të gjithë aktorët publikë të interesuar, sipas dispozitave të Ligjit Per	Grup Pune Gjastënujori i dytë 2026

				Njoftimin dhe Konsultimin Publik.	
Fusha e menaxhimit dhe administrimit të pronave					
17.	Mungesë e një plani afatgjatë strategjik për mirëmbalimin e pronave.	Operacionet(Procesi)	Shumë	Hartim i strategjisë/Planit për vënie në përdorim të aseteve vendore, duke përfshirë burimet financiare dhe dhe politikat fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë/planit	Grup Pune Gjastërmujori I parë 2026
18.	1. Kapacitetet njëzëore të punafutësishme dhe mungesë kualifikimesh sipas kuartrit rregullator të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit. 2. Kapacitete financiare dhe teknike të punafutësishme për realizimin e detyrave funksionale në terren për pronat dhe planifikimin e territorit.	Operacionet(Procesi)	Shumë	1. Marrja e masave për sigurimin e numrit të punafutësishëm dhe sipas kualifikimit përkatës të profesionistëve sipas ligjit. 2. Analizë e nevojave në kuadër të realizimit të detyrave në territor dhe marrja e masave për parashikimin e tyre në buxhetin e Bashkisë.	Kryetari/Grup Pune Gjastërmujori I parë 2026
19.	Mos hipotekimi i pronave të bashkisë si triedhojë e: - Mungesës së tendëve për ta financuar këtë procesi. - Mospërcorimit dhe mungesë komunikimi me zyrtën e hipotekës.	Operacionet(Procesi)	Shumë	1. Bashkëpunimi me ASHK dhe vlerësimi i mundësisë së lehtësimin të formave të pagës për regjistrimin e tregjyer të pronësive në favor të NJVV Fushë-Arrëz. 2. Hartim i një MoU për krijimin e linjave të qarta të komunikimit/rakordimit për procesin e hipotekimit.	Grup Pune Gjastërmujori I dytë 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.105// Prot.

Shkodër, më 11.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz Nr.3, datë 27.01.2025.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.1, pika 1.6, germa d, neni 18, neni 29, neni 54/k, neni 55/3, neni 64 germa c, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", shqyrtoi *VKB Fushë-Arrëz Nr.3, datë 27.01.2025 "Mbi miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për 2025-2027"*.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm ligjor.

Duke ju falënduar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 235 prot.

Fushë-Arrëz, më 29. 01. 2025

VENDIM

Nr. 3, datë 27. 01. 2025

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ
PËR PERIUDHËN 2025-2027.**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 1, germet "c", "d", "e", "m" nenit 9, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 33, 43, 47, 52, 54, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, në mbledhjen e tij të datës 29. 07. 2024, pasi u njoh me Planin e Integritetit të paraqitur nga Grupi i Punës "IDM" dhe Administrata e Bashkisë Fushë-Arrëz, pas diskutimeve

VENDOSI:

Të miratojë Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 të përgatitur nga grupi i punës IDM sipas materialit bashkëlidhur këtij projekti.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Fushë-Arrëz.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 29. 01. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

03/01/25

Nr. 239/1 prot.

Fushë-Arrëz, më 30. 01. 2025

PËR: PREFEKTURËN E QARKUT

SHKODËR

NGA: KËSHILLI I BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Dërgim i Vendimit të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë **Vendimin Nr.3, datë 27.01.2025** të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, për **“Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027”**.

Duke ju siguruar për bashkëpunimin tonë të mëtejshëm!

SEKRETAR

Naze SELIMAJ